REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 6597 prot. Tiranë, më 19 / 11 / 2026

Lënda: **Depozitim projektligji.**

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim **projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar.**

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES
Enriketa Jaho

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2026

"PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2020 "PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 41 riformulohet si vijon

"*1. I burgosuri përfiton të njëjtin standard të kujdesit shëndetësor si popullsia e përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky kujdes shëndetësor ofrohet pranë çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale dhe, sipas nevojës, në institucionet e shërbimit spitalor.*
2. Shërbimet e kujdesit shëndetësor sigurohen gjatë kohës së qëndrimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale nga strukturat përkatëse në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor.
3. Të burgosurit përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të legjislacionit në fuqi, dhe përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor, sipas këtij ligji.
4. I burgosuri ka të drejtë të kryejë vizitat mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion të kujdesit shëndetësor brenda vendit, me kushtin që t'i mbulojë vetë shpenzimet mjekësore dhe çdo shpenzim tjetër që rrjedh si pasojë e zgjedhjes së mjekut prej tij. Përjashtimisht, të burgosurit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë mund të përfitojnë vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion të kujdesit shëndetësor të zgjedhur prej tyre vetëm pas vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarit. E drejta për të kryer vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një spital të zgjedhur prej të burgosurve nuk zbatohet për të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë, sipas parashikimit të nenit 17 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur shërbimi i kërkuar nuk

ofrohet nga shërbimi i kujdesit shëndetësor në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucionet e shërbimit spitalor.

5. Personeli mjekësor siguron vlerësimin dhe vizitën mjekësore të të burgosurit të sëmurë, me kërkesë të këtij të fundit, të paraqitur me shkrim ose verbalisht pranë personelit shëndetësor ose personelit të sigurisë në regjim. Vizita kryhet pa vonesë, në përputhje me urgjencën dhe nevojat shëndetësore të të burgosurit. Personeli mjekësor kryen gjithashtu kontrolle periodike shëndetësore për të gjithë të burgosurit, sipas një grafiku të hartuar nga shefi i shërbimit të kujdesit shëndetësor në burgje.

6. Struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin shëndetësor, si dhe çdo institucion varësie i tij inspektojnë, të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjendjen higjieno-sanitare të mjediseve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor për parandalimin e sëmundjeve infektive.

7. Të burgosurit gëzojnë të njëjtat të drejta dhe garanci lidhur me kërkimin shkencor dhe eksperimentimin mjekësor si popullsia e përgjithshme. Ndalohet përfshirja e të burgosurve në eksperimente mjekësore ose kërkime shkencore pa pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar, si dhe në çdo rast kur ato mund të cenojnë integritetin fizik ose mendor, dinjitetin dhe të drejtat e tyre, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

8. Rregullat e detajuara për ngritjen, funksionimin dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga struktura e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, si dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë."

Neni 2

1. Në fjalinë e dytë, të pikës 2, të nenit 42, togfjalëshi *"ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit"*, shfuqizohet.

2. Pika 10 dhe 11 e nenit 42 shfuqizohen.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

NIKO PELESHI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 81/2020 "PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE", TË NDRYSHUAR

QËLLIMI I PROJEKTAKTIT

Projektligji synon të realizojë transferimin e përgjegjësisë për ofrimin e kujdesit shëndetësor ndaj personave të burgosur nga strukturat e sistemit penitenciar pranë strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ky ndryshim synon të garantojë që personat e privuar nga liria të kenë akses në shërbime shëndetësore cilësore, të barabarta dhe të ofruara sipas të njëjtave standarde që zbatohen për pjesën tjetër të popullsisë. Në këtë mënyrë, synohet të sigurohet një ndarje më e qartë e përgjegjësive institucionale dhe të forcohet integrimi i shërbimit shëndetësor në sistemin publik shëndetësor, të bazuar në nevojat dhe të drejtat shëndetësore të çdo individi.

ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT

Projektligji synon të sjellë ndryshime në modelin aktual të organizimit dhe ofrimit të kujdesit shëndetësor për personat e burgosur, duke rishikuar mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive institucionale në këtë fushë dhe duke e integruar ofrimin e këtij shërbimi në strukturat e sistemit shëndetësor publik.

Në këtë drejtim, projektligji parashikon që shërbimet shëndetësore për këtë kategori të ofrohen nga strukturat në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me synimin për të siguruar një organizim më të qartë dhe për të garantuar të njëjtin standard të kujdesit shëndetësor që zbatohet për pjesën tjetër të popullsisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet të reflektohen në kuadrin ligjor vendas standardet dhe parimet e përcaktuara në Rregullat Evropiane të Burgjeve, veçanërisht për sa i përket trajtimit të personave të burgosur në kuadër të eksperimenteve mjekësore dhe kërkimeve shkencore.

Në këtë kontekst, riformulimi i dispozitës përkatëse synon të përcaktojë në mënyrë më të qartë garancitë që duhet të respektohen në këtë drejtim, duke vendosur theksin te pëlqimi i lirë dhe i informuar i personit të burgosur, si dhe te mbrojtja e integritetit të tij fizik dhe mendor, dinjitetit dhe të drejtave të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në tërësi, ndërhyrjet e propozuara synojnë të përshtatin kuadrin ligjor, të qartësojnë përgjegjësitë përkatëse institucionale dhe të përcaktojnë garanci më të strukturuara për ushtrimin e të drejtave të tyre si pacientë.

VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me aktet e Bashkimit Evropian.

PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 parashikon riformulimin e nenit 41 të ligjit.
Pika 1 përcakton se i burgosuri përfiton të njëjtin standard të kujdesit shëndetësor si popullsia e përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kujdesi shëndetësor ofrohet pranë çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale dhe, sipas nevojës, në institucionet e shërbimit spitalor.
Pika 2 përcakton se shërbimet e kujdesit shëndetësor gjatë qëndrimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale sigurohen nga strukturat përkatëse në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor.
Pika 3 parashikon përfshirjen e të burgosurve në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të legjislacionit në fuqi, duke u garantuar përfitimin pa pagesë të të gjitha shërbimeve që ofron skema e sigurimit shëndetësor, sipas këtij ligji.
Pika 4 rregullon të drejtën e të burgosurit për të kryer vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion të kujdesit shëndetësor brenda vendit, me kusht që të mbulojë vetë shpenzimet mjekësore dhe çdo shpenzim tjetër që rrjedh nga zgjedhja e tij. Për të burgosurit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm pas vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarit. Ndërsa për të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm në burgun e

sigurisë së lartë, sipas nenit 17 të këtij ligji, kjo e drejtë nuk zbatohet, me përjashtim të rasteve kur shërbimi i kërkuar nuk ofrohet nga shërbimi i kujdesit shëndetësor në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucionet e shërbimit spitalor.

Pika 5 përcakton detyrimin e personelit mjekësor për të siguruar vlerësimin dhe vizitën mjekësore të të burgosurit të sëmurë, me kërkesë të këtij të fundit. Kërkesa mund të paraqitet me shkrim ose verbalisht pranë personelit shëndetësor ose personelit të sigurisë në regjim. Vizita kryhet pa vonesë, në përputhje me urgjencën dhe nevojat shëndetësore të të burgosurit. Gjithashtu, parashikohet kryerja e kontrolleve periodike shëndetësore për të gjithë të burgosurit, sipas një grafiku të hartuar nga shefi i shërbimit të kujdesit shëndetësor në burgje.

Pika 6 përcakton se struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin shëndetësor, si dhe çdo institucion në varësi të saj, kryejnë inspektime në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të paktën dy herë në vit. Inspektimet lidhen me gjendjen higjieno-sanitare të mjediseve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor për parandalimin e sëmundjeve infektive.

Pika 7 përcakton se të burgosurit gëzojnë të njëjtat të drejta dhe garanci lidhur me kërkimin shkencor dhe eksperimentimin mjekësor si popullsia e përgjithshme. Gjithashtu, ndalohet përfshirja e tyre në eksperimente mjekësore ose kërkime shkencore pa pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar, si dhe në çdo rast kur këto veprimtari mund të cenojnë integritetin fizik ose mendor, dinjitetin dhe të drejtat e tyre, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Pika 8 parashikon që rregullat e detajuara për ngritjen, funksionimin dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga strukturat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, si dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur, të përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 2 parashikon ndryshime në nenin 42 të ligjit në fuqi. Konkretisht, në fjalinë e dytë të pikës 2 hiqet togfjalëshi "ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit". Gjithashtu, parashikohet shfuqizimi i pikave 10 dhe 11 të këtij neni.

Neni 3 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit, duke parashikuar se ai hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi ofrimi i shërbimit do të vijojë të realizohet nga stafi mjekësor. Ndryshimi konsiston në transferimin e përgjegjësisë administrative dhe të zërit përkatës buxhetor pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ky riorganizim nuk sjell shtim të shpenzimeve buxhetore, por vetëm rishpërndarje të fondeve ekzistuese ndërmjet institucioneve përgjegjëse.